



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-016-36604

Me datë 20.06.2018

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, nenit 2 dhe 13 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve, 01-Nr-16-586, e datës 31.01.2013, e në mbështetje të nenit 44, lidhur me nenin 49, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016" Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Mbi formimin e komisionit

1. Formohet komisioni për shqyrtimin e të gjitha kërkesave për ti ndihmuar personat fizik për ndihma momentale, për shqyrtimin e lëndëve për banjo klimatike dhe për subvencionimin e lindjeve që dërgohen në Drejtorinë për shëndetësi dhe mirëqeni sociale, në këtë përbërje:
 - 1.1. Dr. Sevdije KOKOLLARI-----kryesuese
 - 1.2. Shehide BYTYÇI-----anëtare
 - 1.3. Besmir IBALLI-----anëtar
2. Detyrë e këtij komisioni është që të bëjë shqyrtimin e të gjitha kërkesave që dërgohen nga personat fizik me nevojë, për rastet urgjente të shkaktuar nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, varfëri të skajshëm për familje apo individ të caktuar me sëmundje të rënda që kërkojnë mjekim të kushtueshëm, për shqyrtimin e lëndëve për banjo klimatike dhe për subvencionimin e lindjeve dhe pas shqyrtimit të kërkesave ti rekomandojnë Drejtorit të Drejtorisë përkatëse, për veprimet e mëtutjeshme.
3. Kryetari i Komunës i jep autorizim Drejtorit të Drejtorisë përkatëse, që pas rekomandimit të komisionit për shqyrtimin e kërkesave, ta miraton apo ta refuzon kërkesën sipas rekomandimit të komisionit.
4. Ky aktvendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen;

Anëtarët e komisionit

Evidenca